

VENDIM
Nr.720, datë 20.10.2011

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.37, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, NË KOMUNËN ZAPOD TË QARKUT TË KUKËSIT”, DHE PËR
DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.112, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË
DO TË TRANSFEROHEN NË PËRDORIM TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE
KOMUNA ZAPOD TË QARKUT TË KUKËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, pyje dhe kullota, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zapod, të qarkut të Kukësit, që i bashkëlidhet vendimit nr.37, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave.

Lista shtesë me 1 (një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, fillon me numër inventari prone 243 dhe mbaron me numrin 259.

2. Miratimin e shtesës së listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore komuna Zapod, të qarkut të Kukësit, që do t’i transferohen në përdorim kësaj njësie, që i bashkëlidhet vendimit nr.112, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave.

Shtesa e listës përfundimtare me 5 (pesë) fletë, që fillon me numër inventari prone 110 dhe mbaron me numër 259, si dhe tabela me lidhjen nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Zapod për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha